



VENDIM
Nr. 54 Datë 03.05.2013

MBI
SHTYRJEN E AFATIT TE VENDIMIT NR. 161, DATË 07.12.2012, TË
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE

Në mbështetje të nenit 8, pika b) dhe ç), nenit 9 dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03.05.2013, pasi shqyrtoi relacionin e grupit te punes,

Konstatoi se:

- Ekzistojne paqartësi dhe pasiguri të treguesve kryesorë të llogaritjes së tarifës së energjisë elektrike për gjithë aktivitetet e rregulluara;
- Shoqëria CEZ Shpërndarje operon me statusin në administrim të përkohshëm, situatë e cila e bën të pamundur vendosjen e objektivave për treguesit e performances;
- Aktualisht ERE me vendimet e dates 7.12.2011 ka aprovuar nje tarifë mesatare trevjecare për periudhen 2012-2014 për të gjithë aktivitetet e rregulluara, bazuar në mesataren e te ardhurave te kerkuara per te tre vitet;

Si dhe referuar situatës aktuale ne sektorin e energjise elektrike, e cila është e ngjashme për nga pamundesia e vendosjes se objektivave me situaten e vitit 2009, vit kur u mbyll procesi i privatizimit te 76% te aksioneve te kompanise se shperndarjes dhe ku ERE shtyu afatin e zbatimit te tarifave te vitit 2008 pergjate vitit 2009 (Vendimi nr.7 date 26 Janar 2009).

Per gjithë sa me sipër cituar Bordi i Komisionereve të ERE-s

Vendosi:

1. Shtyrjen e afatit të zbatimit të vendimit nr. 161, datë 07.12.2012, të Bordit të Komisionerëve të ERE, deri në datë 31 Dhjetor 2013.

2- Perditesimin dhe kompesimin e te gjitha efekteve te mundshme financiare ne vitin pasardhes brenda të njëjtës periudhë rregullatore 2012-2014.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI